



Nr.13-111/01-0072051/22

Data:24.08.2022

Bazuar në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Ligjin për Institucionet e Kulturës Nr. 02/L-57, Neni 37, Ligjin për Teatrot Nr. 04/L – 106, Neni 13 Pika 2, 3 dhe 4 si dhe Statutin e Teatrit Neni 13 Pika 2, Neni 14, Komuna e Podujevës shpall:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Teatri i Qytetit “Avdush Hasani” - Komuna e Podujevës

Titulli i punës: Drejtor i Përgjithshëm i Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani”

Kategoria funksionale: Nivel Drejtues

Koeficienti: 9.5

Lloji i emërimit: Me mandat

Detyrat kryesore:

- Bën menaxhimin financiar, administrativ, teknik dhe promovues të Teatrit;
- Zbaton vendimet e Këshillit Drejtues të Teatrit;
- Propozon organizimin e brendshëm të Teatrit tek Këshilli Drejtues;
- Përfaqëson Teatrin brenda dhe jashtë vendit;
- Propozon buxhetin vjetor para Këshillit Drejtues;
- Kërkon, aplikon dhe negocion për marrjen e donacioneve;
- Mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe të donacioneve;
- Menaxhon mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesës së Teatrit;
- Menaxhon bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Këshillit Drejtues;
- Kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut të teatrit.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Kualifikim superior nga fusha e Teatrit ose nga lëmitë tjera të kulturës;
- Të ketë 5 vite përvojë pune profesionale;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët;
- Njohuri të punës me kompjuter, Word, Excel etj.
- Të ketë shkathësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe ndër njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës dhe në grupe;
- Të ketë aftësi të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e kontakteve brenda dhe jashtë teatrit.

Rregullimi i mandatit: Bazuar në nenin 13, paragrafi 3 të Ligjit për Teatrot nr.04/L-106, mandati i Drejtorit të përgjithshëm të teatrit është 4 (katër) vite me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

- Diplomen e shkollimit të kryer të nivelit përkatës (fotokopje e vërtetuar);
- Dëshmitë për përvojë pune;
- Dokumentin e identifikimit;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime (nga Gjykata).

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 24.08.2022 deri me dt.22.09.2022.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë, nga data 23.09.2022 deri me datën 07.10.2022.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit publik të administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Zyrën e Personelit, në këtë numër të telefonit 038/ 200-41014.

Rezultatet shpallen në linkun <https://konkursi.rks-gov.net>